

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: **Bashkimit të operatorëve ekonomikë “SPHAERA” shpk & “ARKIMADE” shpk & “ARCHISPACE” shpk**

Adresa: Tiranë, QAZIM VATHI 106; Tiranë, Rruga Himë Kolli, Ndertesa Nr.24, Hyrja Nr.9, Ap.14; Tiranë, Njesia Administrative Nr.5, Rruga "Sami Frasheri", Pallati Nr.45, Hyrja Nr.2. Zyra Nr.10.

Procedura e prokurimit/lotit: **“Procedurë e hapur e thjeshtuar”, Mbikqyrja e punimeve për objektin: Rehabilitim i qendrës Kinostudio”.**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF- 44224-10-03-2022**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: **Rehabilitim i qendrës Kinostudio”.**

Fondi limit: 4,492,631.66 (katër milion e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e një pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2022, miratuar me Vendim Nr.166, datë 24.12.2021 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2022” (e ndryshuar)”.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarike nga data e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes për të njëjtin objekt.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 14.10.2022, ora 10:00

Publikimet e mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.139, datë 10.10.2022.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “A & E ENGEENIERING” shpk NUIS K72113010E
Vlera e ofertës = **3,938,701.66** (tre milion e nëntëqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e një pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Instituti i Konsulencës në Ndërtim “IKN” shpk & “Imes – D” shpk NUIS K71828007J; NUIS K82430006C

Vlera e ofertës = **3,938,701.67** (tre milion nëntëqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e një pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “SPHAERA” shpk & “ARKIMADE” shpk & “ARCHISPACE” shpk NUIS J81809003U;NUIS L01906030A;NUIS L42403012A

Vlera e ofertës = **3,938,701.67** (tre milion nëntëqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e një pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

4. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “TOWER” shpk & “DRICONS” shpk
NUIS L21717003H; NUIS L52013020H

Vlera e ofertës = **4,023,821** (katër milion e njëzet e tre mijë e tetëqind e njëzet e një) lekë pa TVSH.

5. Operatori ekonomik “BN PROJECT” shpk NUIS L21305035S

Vlera e ofertës = **4,088,290.32** (katër milion e tetëdhjetë e tetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë pikë tridhjetë e dy) lekë pa TVSH.

6. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “ZENIT & CO” shpk & “STUDIO SEVICES “K – SA” shpk NUIS K61731002D; NUIS L71305518R

Vlera e ofertës = **4,223,073.76** (katër milion e dyqind e njëzet e tre mijë e shtatëdhjetë e tre pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “A & E ENGEENIERING” NUIS K72113010E

Operatori ekonomik “A & E ENGEENIERING” shpk nuk përmbush pikën 1, germa c, të Kriterëve të Veçanta për Kualifikim lidhur me deklaratimet në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pasi nga verifikimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, rezulton se nuk është plotësuar paragrafi Pjesa II, Shkaqet e përjashtimit, paragrafi 2,4 dhe 8. Çka bie në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në Shtojcën 8, Formulari i Kriterëve Të Përzgjedhjes/Kualifikimit, Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit “Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9”.

Mungesa e dokumentacionit të plotë ligjor, ekonomik dhe teknik u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Nga shqyrtimi i kësaj ofertë mbështetje të Nenit 92, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu X, Neni 82, pika 2, KVO e shpall të pavlefshme këtë ofertë, pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Instituti i Konsulencës në Ndërtim “IKN” shpk & “Imes – D” shpk NUIS K71828007J;NUIS K82430006C

Operatori ekonomik “Instituti i Konsulencës në Ndërtim “IKN” shpk nuk përmbush piken 1, germa c, të Kriterëve të Veçanta për Kualifikim lidhur me deklaratimet në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pasi nga verifikimi i Formularit

Përmbledhës te Vetëdeklarimit, rezulton se nuk është deklaruar *Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik, Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE). Sipas dokumentacionit te dorezuar rezulton se “Instituti i Konsulencës në Ndërtim “IKN” shpk ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me operatorin e konomik “IMES - D” shpk, per kete procedure prokurimi.*

Operatori ekonomik “Instituti Konsulences ne Ndertim IKN” shpk nuk plotëson pikën 4, të DST, kriteret e veçanta të kualifikimit Kapaciteti teknik ku citohet se: Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha shërbimeve në objekt, te perfshire ne licensen e shoqerise ose pajisur me license individuale,... pasi në Formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST nuk ka deklaruar stafin inxhinierik i cili do të kryejë shërbimin për këtë procedurë prokurimi po ka deklaruar vetëm profile inxhinierike.

Operatori ekonomik “Instituti Konsulences në Ndërtim IKN” shpk nuk plotëson pikën 5 të DST, kriteret e veçanta të kualifikimit Kapaciteti teknik ku citohet se: Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar... pasi në Formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST nuk ka deklaruar personelin e kërkuar i cili do të kryejë shërbimin për këtë procedurë prokurimi po ka deklaruar vetëm profil punonjësish.

Operatori ekonomik “Imes – D” shpk nuk përmbush piken 1, germa c, Kapaciteti teknik, te Krieteve te Vecanta per Kualifikim lidhur me deklarimet ne Formularin Përmbledhës te Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pasi nga verifikimi i Formularit Përmbledhës te Vetëdeklarimit, rezulton se nuk është deklaruar *Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik, Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE). Sipas dokumentacionit te dorezuar rezulton se “Imes – D” shpk ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me operatorin e konomik “Instituti i Konsulencës në Ndërtim “IKN” shpk, per kete procedure prokurimi.*

Operatori ekonomik “Imes – D” shpk nuk plotëson pikën 5, germa a, Kapaciteti teknik, të Krieteve të Veçanta per Kualifikim, ku citohet se: Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar per 1 (një) punonjës specialist “Ekspert Zjarrefikës në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpetim” në përputhje me Ligjin Nr.152/2015 "Për sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate dhene nga Drejtoria MZSH, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim"). Nga verifikimi i dokumentit Formularit Përmbledhës te Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, rezulton se nuk ka deklaruar punonjës të çertifikuar për profilin e mësipërm,

Mungesa e dokumentacionit të plotë ligjor, ekonomik dhe teknik u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Nga shqyrtimi i kësaj ofertënë mbështetje të Nenit 92, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu X, Neni 82, pika 2, KVO e shpall të pavlefshme këtë ofertë, pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Operatori ekonomik “BN PROJECT” shpk

NUIS L21305035S

Operatori ekonomik “BN PROJECT” shpk nuk permbushsh kërkesat e përcaktuara në Shtojcën 8, Formulari i Kritereve Të Përzgjedhjes/Kualifikimit, Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi nga verifikimi dokumentacionit të dorezuar ne sistemin elektronik të prokurimit rezulton se nuk ka dorezuar dokumentacionin e kërkuar sipas shtojces 8.

Mungesa e dokumentacionit të plotë ligjor, ekonomik dhe teknik u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Nga shqyrtimi i kësaj ofertënë mbështetje të Nenit 92, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu X, Neni 82, pika 2, KVO e shpall të pavlefshme këtë ofertë, pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “ZENIT & CO” shpk & “STUDIO SEVICES “K – SA shpk **NUIS K61731002D; NUIS L71305518R**

Operatori ekonomik ZENIT & CO shpk nuk përmbush piken 4, të Kritereve të Veçanta për kualifikim ku percaktohet se operatori ekonomik duhet te kete: Një punësim mesatar i të paktën 20 (njëzet) personave, për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave të vërtetuar me; a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. b)Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit me operatorin ekonomik STUDIO SEVICES “K – SA” shpk rezulton se ZENIT & CO” shpk ka marrë përsipër të kryejë 80% të shërbimeve për këtë procedurë prokurimi, dhe duhet te kete ne dispozicion 16 punonjës. Nga verifikimi dokumentacionit të dorezuar ne sistemin elektronik te prokurimit rezulton se në Shtojcën Nr.9 të Formularit të vetëdeklarimit Pjesa III/B ka deklaruar 15 punonjës i gje e cila bie në kundërshtim me pikën 4, të Kritereve të Veçanta për kualifikim në DST.

Bashkimi i operatoreve ekonomik “ZENIT & CO” shpk & “STUDIO SEVICES “K – SA” shpk nuk përmbush piken 3, të Kritereve të Veçanta për kualifikim ku percaktohet se: “Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha shërbimeve te mbikqyrjes, të perfshirë në licensen e shoqerisë. Për stafin inxhinierik duhet të paraqiten kontratë pune (e vlefshme), diplomë përkatëse, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqerisë për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. 1(një) Inxhinier Ndërtimi Profili Infrasturkturë”. Nga verifikimi i Formularit Përmbledhës te Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, te dorezuar ne sistemin elektronik te prokurimit rezulton se nuk ka deklaruar 1 (një) Inxhinier Ndertimi Profili Infrasturkturë.

Mungesa e dokumentacionit të plotë ligjor, ekonomik dhe teknik u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Nga shqyrtimi i kësaj ofertënë mbështetje të Nenit 92, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu X, Neni 82, pika 2, KVO e shpall të pavlefshme këtë ofertë, pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e operatorëve ekonomikë “SPHAERA” shpk & “ARKIMADE” shpk**, me adresë Tiranë, QAZIM VATHI 106; Tiranë, Rruga Himë Kolli, Ndertesa Nr.24, Hyrja Nr.9, Ap.14; Tiranë, Njesia

Administrative Nr.5, Rruga "Sami Frasheri", Pallati Nr.45, Hyrja Nr.2. Zyra Nr.10, oferta e paraqitur me vlerë totale prej **3,938,701.67** (tre milion nëntëqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e një pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".